



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:236498

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05706761

**A.C.nr.1972/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Merita Emini me vendbanim në Rr. “Tringë Smajli”, ndërtesa 10 katëshe, nr.84, Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të kontestit të punës - anulimi i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3567/19 datë 28.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë**, ankesa e paditëses Merita Emini me vendbanim në Rr. “Tringë Smajli”, ndërtesa 10 katëshe, nr.84, Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3567/19 datë 28.01.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.3567/19 datë 28.01.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon : “...**REFUZOHET** në tërësi e pa bazuar kërkespadija e paditëses Merita Emini nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi me nr.01/704/2019 i datës 06.06.2019, dhe të obligohet Dogana e Kosovës që ricaktimin e paditëses Merita Emini ta bëjë në pajtim me nivelin

*drejtues të kategorisë funksionale që ka pasur para ricaktimit dhe nivelin e njëjtë të pagës.*

*Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”.*

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses, për shkak të: vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta prishë aktgjykimin C.nr.3567/19 datë 28.01.2021, dhe lëndën ta kthej në rigjykim, dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

### **-Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Merita Emini me vendbanim në Rr. “Tringë Smajli”, ndërtesa 10 katëshe, nr.84, Komuna Prishtinë, me datë 04.08.2021, ka parashtruar padi për anulimin e vendimit nr.01/704/2019 të datës 06.06.2019, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim 3567/19 datë 28.01.2021, me të cilin aktgjykim e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon: “...Neni 12 paragrafi 2 i Ligjit nr.06/L-133 për ndarjen Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019, ndër të tjera parasheh se : “...Stafi civil i Doganës përmes kësaj dispozite merr statusin e shërbyesit publik doganor me gradën – pozitën fillestare te doganës...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse dhe atë paditësja Merita Emini ka krijuar marrëdhënie pune, dhe ka nënshkruar kontratë të punës 01/507/2019 datë 15.04.2019 me të paditurën me kohë të pacaktuar në pozitën Oficer Doganor, me gradën OD1, ku në nenin 5.2 të Kontratës së punës 01/507/2019 datë 15.04.2019 të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse ndër të tjera thuhet se “...Për shkak të natyrës dhe kërkesave të punës, mund të paraqitet

*nevoja të shërbeni në cilindo nga vendet e punës në Doganën e Kosovës...”, ndërsa e paditura me vendim për emërim të përkohshëm nr.01/517/2019 datë 15.04.2019, është emëruar përkohësisht ushtrues detyre udhëheqës i sektorit përkrahës të tik-ut, me gradën OD4.*

Në nenin 2 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se: *“1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t’i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre. 2. Pjesëmarrësit mund t’i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është paraparë me këtë ligj, për derisa nuk rezulton diçka tjetër nga dispozitat e këtij ligji ose të kuptimit dhe qëllimit të tyre”.*

Pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), e Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nga se sipas paditësit dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjashtë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimi ankimor i paditëses se caktimi i paditëses në pozitën fillestare – oficer doganor grada 1 – OD1) është grada më e ulët në strukturën organizative të të paditurës, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që paditësja e ka nënshkruar kontratën e punës 01/507/2019 datë 15.04.2019 me të paditurën, ku në këtë kontratë ndër të tjera thuhet se : *“ ... Pozita Oficer Doganor, Grada OD1...”,* ndërsa në nenin 15 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se: *“Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”.*

Sa i përket pretendimit ankimor të paditëses, se e paditura në kundërshtim me ligjin e punës ia ka ndërpre njëanshëm marrëdhënien e punës ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në shkresat e lëndës nuk ka vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, në shkresat e lëndës është vendimi nr.139 datë 22.08.2018, me të cilin vendim e paditura ka shpallë konkurs pune me që paditësit i ka skaduar afati i kontratës së punës.

Në nenin 7.1 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decidive thuhet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Pretendimi ankimor i paditëses se baza juridike e padisë së paditëses ka qenë e bazuar në ligj dhe është mbështetur në kontratën e punës/aktemërimin të cilin paditësja e ka me afat të pacaktuar, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në nenin 1.2 të kontratës së punës 01/507/2019 datë 15.04.2019, e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse ndër të tjera thuhet se : “ ... *Kjo kontratë zëvendëson të gjitha kontratat tjera me Doganën e Kosovës...*”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuartë, dhe rrjedhimisht i njëjti është në harmoni edhe me arsyetimin e aktgjykimit.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore të paditëses të parashtruara në ankesë, Gjykata e Apelit i mori parasysh dhe gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.1972/2021 datë 20.05.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**

**Bujar Muzaqi**